V E N D I M
Nr.223, datë 15.5.1995

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.152, DATË 5.4.1994 "PËR KUSHTET E PËRFITIMIT, SHUMËN DHE PROCEDURËN E DHËNIES SË PENSIONEVE TË POSAÇME SHTETËRORE DHE TË SHTESAVE TË PENSIONEVE"

Në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrve

V E N D O S I :

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.152, datë 5.4.1994 "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve", ndryshuar me vendimin nr.137, datë 20.3.1995, në fund të paragrafit të parë të pikës 1 shtohen fjalët: "... pavarësisht nga kategoria".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 1995.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi